



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KLOS
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

Dt.10.12.2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim Urë Beton Arme Fshati Ketë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233000-9
“Ndërtim, themele dhe punime terreni për autostrada, rrugë”.

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,926,568 (Tre milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Klos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 të DST), në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në

VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26. Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mësipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare **(2022-2023-2024)** të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit). *Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” përcaktohet se : ”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".*

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **(2022-2023-2024)** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025** ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë perpara nenshkrimin të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40%** të fondit limit të perlllogaritur të prokurimit të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pesë viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura Tatimore

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura Tatimore

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime germimi ne toke
- NP-4 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit).

2.5 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër mesatar të punonjësve të siguruar jo më pak se **16 (gjashtembedhjetë) punonjës** të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Gusht – Shtator 2025**

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Gusht – Shtator 2025**
- Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Gusht – Shtator 2025**

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **16 (gjashtembedhjetë) punonjës**, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **3 muajve** nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”(periudha në të cilën është hartuar dhe miratuar projekt zbatimi). Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhënë garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës:

”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per periudhen Prill – Qershor 2024, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën **16** persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

2.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne liçensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse,CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per periudhen **Gusht – Shtator 2025**, konkretisht:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve ekonomik, sipas punimeve qe merr persiper te realizoje referuar Preventivit te punimeve, secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt, të cilët duhet të jetë te përfshirë në liçencën e shoqërisë.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve: ndërtimi, mekanik, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP-1, NP-5, është domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e Inxhinierit të Ndërtimit. Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla, punimet e shtresave, punimet

e muraturës, betonit, hekurit suvatimet. Punimet ndërtimore përbëjnë një pjesë e të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe plotësimi i kërkesave për mbrojtjen nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës. Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit. Metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standartet dhe kriteret e zbatimit nga inxhinier ndërtimi.

2.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar e kontrate pune të vlefshme, pajisur me diploma/certifikata të formimit profesional lëshuar nga autoritete përgjegjëse të akredituara/licensuara, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Gusht – Shtator 2025** konkretisht minimumi:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Teknik Topograf
- 2 (dy) Punonjes Karpentiere
- 3 (tre) Punonjes Betonues
- 1 (një) Hidroizolues
- 1 (një) Hekurkthyes
- 1 (një) Punonjes Buldozerist
- 2 (një) Punonjes Eskavatorist
- 1 (një) Punonjes Automakinist
- 2 (dy) Drejtues Mjeti (shofer)

Për këta punonjes, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (Diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës të vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën në SPE me të dhënat si më poshtë :

Nr .	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesion i	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr.Amzes/ diplomes/certifikates profesionale	nr.nipt ne rast se subjekt i eshte privat
1					
2					
etj					

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lysterje me bojë etj. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të

vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*). Bazuar në kriteret elementare të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

- Në lidhje me 1 (një) Teknik ndertimi prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit si (punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e betonit dhe hekurit) me sukses Kjo kërkesë përputhet me volumet e punimeve referuar analizës teknike të preventivit si dhe afateve kohore të përcaktuara në grafikun e punimeve.
- Në lidhje me 1 (një) Teknik Topograf, prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit në përputhje me projektin duke gjykuar që objekti ka nevojë për piketime të vazhdueshme. Kjo kërkesë përputhet me volumet e punimeve referuar analizës teknike të preventivit si dhe afateve kohore të përcaktuara në grafikun e punimeve.
- -Në lidhje me 2 (dy) punonjes karpentiere kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Të tillë punëtorë realizojnë punime të tilla si kryerjen e matjeve dhe prerjeve sipas përmasave të përcaktuara në projekt, bëjnë piketimin dhe armaturën anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit, ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, urave apo strukturave të tjera, duke respektuar radhën e punës, me materiale druri, plastike, apo metalike sipas specifikimeve teknike, montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, kontrollojnë vertikalishtet e armaturës (peshon) me plumbçe, nxjerrin kuotat e lartësisë së katit sipas projektit (për betonimit), lagin armaturën për betonimit, ndërtojnë skelën për armaturën e trarëve dhe soletës duke ndjekur proceset e tjera të punës, vendosin polisterolin ose tullat në soletë apo në struktura të tjera (për rastin e soletave të lehtësuara), bëjnë disarminimin e kolonave, mureve dhe soletës apo strukturave të tjera duke respektuar afatet e duhura, kryejnë pastrimin dhe sistemin e armaturës etj.
- Në lidhje me 3 (tre) Punonjes Betonues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për punimin dhe realizimin e strukturave të betonit.

- Ne lidhje me 1 (nje) Punonjes Hekurkthyes kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës për punimin dhe vendosjen e hekurit në objekt
- Ne lidhje me 1 (nje) punonjes Hidroizolues, kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës në të tij ku janë hidroizolime me emulsion.
- Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtrën nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovratore dhe kryesisht 2 (dy) Punonjes Manovratore Eskavatoriste, 1 (nje) Manovratore Automakiniste, 1 (nje) Manovratore Buldozerist, dhe 2 (dy) drejtues mjeti (shofere) me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetet në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

2.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar personel të kualifikuar/çertifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **Gusht – Shtator 2025** të paktën;

- 1 (një) punonjës që të disponojë Çertifikatën e trajnimit si "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"* Ose kontratë shërbimi me subjekte private të licensuara *për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

ARGUMENTIM: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar

çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, dy punonjësit të cilit duhet të jete të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojnë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Bazuar dhe në V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkojnë një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në rast aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1(një) punonjes Ekspert për ndihmë e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave". Gjithashtu kërkesa për Ekspert zjarrfikës është në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", duke patur parasysh që një zë i rëndësishëm në preventiv është edhe Sistemi i Mbrojtjes kundër Zjarrit. Nisur nga funksioni i tij, objekti i parashikuar të ndërtohet duhet të plotësojë minimalisht standardet infrastrukturore në fuqi, kundrejt institucioneve të arsimit të lartë. Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre", Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi d) Të gjitha objektet, që do të shërbejnë si institucione të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit ose të jenë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundër zjarrit si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike. Projekti i zbatimit përmban të gjitha masat aktive dhe pasive të mbrojtjes nga zjarri, të paraqitura në materialet grafike të të gjithë projekteve, si dhe në preventivin e punimeve, grafikun, relacionet dhe specifikimet teknike përkatëse. Masat për mbrojtjen nga zjarri përmbledhen në projektin e mbrojtjes nga zjarri. Zbatimi i saktë i të gjitha masave dhe punimeve për mbrojtjen nga zjarri është domosdoshmëri dhe detyrim. Në mbështetje të Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe

shpëtimit”, neni 39, pika 3, projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Referuar nenit 42 të po këtij ligji, moszbatimi i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në konstruksionet, objektet e ndërtimit, në ndërtesa të çdo lloji apo aktivitete që ushtrohen në to, ngarkon me përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, personat fizikë e juridikë që i kanë ato në pronësi ose në administrim.

Për ndërtimin e ndërtesës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2015, më sipër cituar dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, është e nevojshme që të angazhohet 1 (një) ekspert zjarrfikës, i cili duhet të jetë pjesë e stafit të OE.

2.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

- **Certifikatë ISO 9001: - Certifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte europiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;
- **Certifikatë ISO 14001: - Sistemi i Menaxherial i Mjedisit ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.
- **Certifikatë ISO 45001: - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.
- **Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve*

të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

- Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.
- **ISO 9001:** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- **ISO 14001:** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.
- **ISO 45001-** është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë

shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë vijon;

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10 Ton - 15 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
2	Kamioncine Veteshkarkuese me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
3	Eskavator me zinxhire me çekiq	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
4	Eskavator me zinxhire me krah te gjate mbi 20 m	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
5	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
6	Rrul shtresash me dhembe	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
7	Autobetoniere kantieri (mjet teknologjik me targa)	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
8	Sistem wellpoint per largim ujerash nga themelet	Ne pronesi ose me qera	Copë	1
9	Autopompe Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
10	Motogjenerator	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
11	Betoniere	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
12	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qera	Copë	2
13	Betonforma	Ne pronesi ose me qera	m2	200
14	Matrapik	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
15	Tranxhe per prerje hekuri	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
16	Bango per kthim hekuri	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
17	Komplet I ndihmes se shpejte	Ne pronesi ose me qera	Copë	5
18	Kokore pune	Ne pronesi ose me qera	Copë	16
19	Jelek fosforeshent	Ne pronesi ose me qera	Copë	16
20	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë	1
21	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë	1
22	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë	1

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- a) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje perkatese si dhe të shoqërohen me aktin e pronësise të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e noteruar).
- b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet te mbuloje afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti,foto). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara te jenë të shoqëruara me foto.
- d) Autoriteti kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve ne terren .Ne rast deklarimi te rreme do te te veprohet ne perputhje me nenin 13 pika 3 germa a te ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 i ndyshuar ”per prokurimin publik”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet “Deklaratë” nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri

dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kerkuar ne funksion te kryerjes se zerave specifike te punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar ne varesi te volumeve dhe grafikut te punimeve pra verteton se ofertuesi i mundshem zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Mjetet kamion veteshkarkues dhe Kamioncine Veteshkarkuese me kapacitet mbajtes 10-15 ton dhe kamioncine veteshkarkuese me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton jane kerkuar per te realizuar zerat e punimeve te cilet kane te perfshire punimet e germimit, largimin e mbetjeve nga objekti, furnizimin me materiale, transporte te ndryshme.

Mjetet eskavator me zinxhire me ceki, eskavator me krahe te gjate dhe eskavator me goma, jane kerkuar per te realizuar punimet e germimit, rrafshimit dhe ngjeshjes se materialeve qe jane te parashikuara te parashikuara ne preventiv.

Mjetet autobetoniere dhe autopompe jane kerkuar si kriter i domosdoshem per te kryer furnizimin, pergatitjen dhe hedhjen e betonit ne ura.

Mjeti Sistem wellpoint per largim ujerash nga themelet, është kerkuar si pasoje e nevojës për të larguar ujin gjatë realizimit të punimeve

Pajisjet motogjenerator, betoniere, vibrtator betoni, matrapik, betonforma, Tranxhe dhe Bango hekuri jane kerkuar si kriter i nevojshem dke gjykuar ne proceset e ndryshme qe do te kryhen ne objekt te parashikuara dhe ne preventivin e punimeve sic jane punimet e betonit, punimet e prishjes, punimet e hekurit, pastrimi i bimesise etj.

Komplet i ndihmes se shpejte, kokore dhe jelek jane kerkuar si mjete te sigurise ne pune.

2.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Analizat e çmimeve të preventivit, Plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, me një relacion shpjegues sipas kërkesave të përcaktuara nga KPT dhe KTZ në fuqi, si dhe Grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi:

Referuar vlerës dhe natyrës së punimeve që ka ky investim objekt prokurimi, **me qëllim vërtetimin se operatorët ekonomik ofertues kanë paraqitur një ofertë reale, të bazuar në një studim të hollësishëm të Projekt - preventivit**, njësia e prokurimit vlerëson se ofertuesit si pjesë e ofertës ekonomike duhet të paraqesin dhe analizën e çmimeve të preventivit që kanë

kryer, dokument i cili nuk përbën kosto shtesë, përkundrazi dëshmon se kanë dhënë një ofertë të përgjegjshme. Gjithashtu, bazuar në përcaktimet e **nenit 15 pika 3** e VKM-së Nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), duke qenë se investimi objekt prokurimi shtrihet në afërsi të parcelave të tokave bujqësore të banorëve, dhe rrugëve rurale automobilistike **me qëllim që të mos ketë dëmtime në këto ara (toka bujqësore), dhe pengesa në lëvizjen e qarkullimin e mjeteve, të banorëve etj.**, njësia e prokurimit vlerëson se, op. ek. pjesëmarrës duhet të bëjnë dhe të paraqesin një plan organizimi i mirëfilltë të punimeve. Plani i organizimit të punimeve duhet të fillojë që me ngritjen e kantierit të objektit, rrugët e aksesit për në kantier, depozitimin e materialeve për ndërtimin e objektit, parkimin e mjeteve të punës, vendosjen e zyrës së kantierit, objektimi i mureve mbajtës, rrethimin e kantierit, vendosjen e tabelave të sinjalizimit, zbatimin e masave tekniko - organizative të objektit, masat e ndihmës së shpejtë etj. Pra, për kryerjen e punimeve për ndërtimin e objektit duhet patjetër të bëhet një plan organizim punimesh me qëllim që punimet të jenë sipas rradhës së duhur dhe të koordinuara në kohë dhe cilësi. Plani i organizimit të punimeve **gjithashtu është i rëndësishëm dhe për zbatimin e punimeve sipas grafikut të punimeve**, ku njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 3 (tre) javë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT